



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 18814 Prot

Shkodër, më 16.12.2022

Lënda: Kërkese për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimi

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Shkodër

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëlidhe po ju dërgojme për shqyrtim dhe miratim projekt - vendimin “ Për disa ndryshime në VKB nr. 1, datë 22.1.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër”, të ndryshuar “

Duke ju uruar punë të mbarë !

KRYETAR
Bashki SPAHIA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2022

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 1, DATË 22.1.2016 “PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË SHKODËR”, TË NDRYSHUAR

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9, pika 1.3. shkronja “a”, “b”, nenit 23, nenit 35, pika 5, shkronja “a”, nenit 54 shkronja “f”, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”; Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe sipas relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë së Shkodrës, sipas dokumentit bashkëngjitur “Paketa Fiskale Bashkia e Shkodrës (e përditësuar)”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Bardh SPAHIA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____, 2022

RELACION

**PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 1, DT. 22.01.2016
“PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË
SHKODËR”, TË NDRYSHUAR**

Bashkia Shkodër ka në zbatim VKB nr. 1, dt. 22.01.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër”, të ndryshuar.

Sipas këtij vendimi kapitulli III.4.8 tarifa për ushqimin në kopshte është 140/Leke ndersa tarifa për ushqimin në çerdhe është 110/Leke.

Bazuar në urdhërin e Ministrisë së Shendetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 76/1 date 24.1.2018 “Për miratimin e ndryshimeve në minute ushqimore të Çerdheve dhe Kopshteve për fëmijet 0-6 vjeç” përcaktohet menuja ditore sipas grupmoshave përkatëse. Mbi bazën e këtij urdhëri dhe bazuar në cmimet përkatëse sipas INSTAT tarifa për ushqimin në kopshte (kuotë /ditore/lekë/fëmijë) është 140 leke dhe tarifa për ushqimin në çerdhe (kuotë /ditore/lekë/fëmijë) është 110 lekë . Si rrjedhojë e rritjes së cmimeve të ushqimeve të verifikuara kjo dhe më të dhënat nga INSTAT si dhe testimi të tregut nga komisioni i ngritur nga Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve me Urdhër nr 28 dt 29.09.2022 për listën e ushqimeve që përdoren më shumë ditore të kopshteve dhe çerdheve është e domosdoshme reflektimi i këtij indeksi inflacioni të kuota ushqimore ditore e fëmijëve në çerdhe dhe kopshte.

Bazuar sa më sipër kërkohet që në paketën fiskale të pasqyrohet ky ndryshim, ku tarifa për ushqimin në Kopshte (kuote /ditore/leke/femije) të bëhet 180/Leke dhe tarifa për ushqimin në çerdhe (kuote /ditore/leke/femije) të bëhet 140/Leke .

Për rrjedhojë ndryshimet janë si më poshtë:

I. NDRYSHIMET NË KAPITULLIN III “TARIFAT VENDORE”

I.1 Tarifa shërbimi nga institucionet e kopshteve dhe çerdheve

Ishte

III.4.8.1	Emertimi	Njësi	Vlerë
1	Tarifë për ushqimin në kopshte	Kuota ditore Lekë/fëmijë	140
2	Tarifë për ushqimin në çerdhet	Kuota ditore Lekë/fëmijë	110

Behet

III.4.8.1	Emertimi	Njësi	Vlerë
1	Tarifë për ushqimin në kopshte	Kuota ditore Lekë/fëmijë	180
2	Tarifë për ushqimin në çerdhet	Kuota ditore Lekë/fëmijë	140

KRYETAR

Bardh SPAHIA



Drejtoria e të Ardhurave:

Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit

Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve

Zv. Kryetar:

Zv. Kryetar:

Opinion i Komitetit Gjyqësor
J. Hila

L. Bardhi

J. Hila

Arbën Çylyzli